

BIOGRAFIA ILIR A.ÇIÇI

Lindur me 2 janar te vitit 1948 ne Tirane nga prinderit Abedin dhe Inajete. Ne moshen 3 vjecare meret nga prinderit e nenes qe banonin ne rrugen "Budi" Tirane, per aresyes se atje ku jetonin ne Koder Kamez (Banesa ku sot eshte Rektorati i Universitetit Bujqesor) nuk kish kopshte .

Ne vitin 1953 fillon shkollen fillore dhe ne vitin 1961 kryen arsimin shtate vjecare ne shkollen "Kosove".Tirane.

Deshira e babait ishte qe te vazhdonja shkollen per agronom dhe kryesisht ne teknikumin bujqesor te Golemit. Pas shume perpjekjesh u be e mundur regjistrimi ne Teknikumin bujqesor Golem Kavaje ku u mundesua nje burse e plote.

Studimet i perfundon ne vitin 1965 ku diplomohet Agronom i mesem dega frutikulture.

Me 1 shtator te vitin 1965 fillon pune si preparator prane Institutit Bujqesor por qe e nderpret pas miratimit te fillimit te studimeve te larta prane Institutut Bujqesor me burse te plote, studime te cilat i perfundon ne shkurt te vitit 1970.

Ne muajin prill te vitit 1970 deri ne fund te muajit gushtit te po ketij viti kryen detyren e kursit ushtarak 5 mujor prane Korpusit te rrethit te Matit ne qytetin e Burrelit.

Me korrik 1970 emerohet me rrethin e Matit si **agronom** Pentarie ku me vendim te seksionitte bujqesise rrethit emerohet agronom ne sektorin e qendres te N.B.Rinia te rrethit Matit pune te cilen e vazhdoi deri me fund te vitit 1971 ku me kerkese te Komitetit te Partise se rrethit Tirane transferohet ne ndermarjen bujqesore Ylli i kuq Kamez.

Në Ndërmarrjen Bujqesore Ylli i kuq Kamëz fillon pune si agronom pentarie ne sektorin Tapize te NB Kamezes.

Sektori kishte nje siperfaqe prej 900 ha pemtore me material mbjelles te importuar nga Italia pergjithesisht me molle, dardhe, kumbulla, pjeshke dhe nje siperfaqe te konsiderueshem me fiq.

Sektori kishte rreth 40 ha me ullishte te vjeter qe realizonin nje rendiment deri ne 17- 20 kg/rrenje.

Gjithashtu sektori kishte 200 krere lope foragjere te planifikuara me nje rendiment 2800 litra qumesht, kishte edhe 200 krere dele.

Sektori kishte nje siperfaqe toke are prej rreth 1000 ha e cila ishte ne dispozicion te blegrorise ne sigurimin e bazes ushqimore.

Dispononte nje baze mekanike qe I pergjigjej detyrave ekonomike te sektorit.

Nga viti 1973 deri ne fund te vitit 1975 kryen funksionin e agronomit te sektorit dhe me vendim te Komitetit te Parties te Rajonin Nr.4 emerohet pergjegjes i sektorit Tapizes detyre te cilen e kryen deri me vitin 1978 ku kalon agronom i sektorit Cerkezesh detyre qe e kryhen deri ne fund te vitit 1981.

Ne dhjetor te vitit 1981 deri ne vitin 1983 aktivizohet ne aparatin e Kryeministrise me grup pune.

Ne Vitin 1984 rikthehen ne NB Kamez me detyren e kryetarit te deges se prodhimit detyre te cilen e ka kryer deri ne vitin 1985.

Me vendim te Ministrit te Bujqesise **ne Tetor te vitit 1985 emerohet Specialist ne Institutin e Kerkimeve te Pemeve Frutore dhe Vreshtave.**

Ne muajin Prill te vitit 1986 e deri me shtator te vitit 1988 ne zbatim te thirjes se Partise punon si K/ agronom (dublant) ne ndermarjen bujqesore ne rrethin e Dibres

Ne tetor te vitit 1988 rikthehet ne Institutin e Kerkimeve te Pemeve Frutore dhe Vreshta ne sektorin e pentarise me detyre kerkues shkencor duke kryer nje seri studimesh ne grup si te nomenklatures se Keshillit te Ministrave, mbi rajonizimin e kulturave dru frutore, studimi i bonetimit te kulturave dru frutore dhe hardhise etj.,projekte te M.Bujqesise kryesisht ne vleresimin dhe pershkrimin e kultivareve te pemeve frutore, projekte te Komitetit te Shkences dhe Teknologjise si grumbullimi,vleresimi, pershkrimi dhe mbrojtja e burimeve gjenetike autoktone te pemeve frutore.

Ne vitin 1991 deri ne tetor te vitit 1995 **komandohet drejtor i Institutit te Kerkimeve te Pemeve Frutore dhe Vreshta** duke vazhduar detyrat kerkimore shkencore me studime dhe projekte.

Gjate kesaj periudhe u krye studimi mbi ristrukturimin e institucionmieve kekrimore shkencore ne vartesi te Ministrise se Bujqesise mbi mundesin e grupimit dhe reduktimit te institucionieve kerkimore shkencore.

Keshtu ne fund te vitit 1995 u vu ne zbatim studimi dhe u realizua bashkimi i Institutit te Kerkimeve te Pemeve Frutore dhe Vreshtve me Institutin e Ulli Agrumeve me qender ne Vlore duke u emertuar Instituti Ulli Agrume.

Po ashtu Instituti i Perime Patateve u bashkua me Institutin e Kerkimeve Bujqesore me qender ne Lushnje, Institute i tokave me ate te Foragjereve me qender ne Fushe Kruje.

Me bashkimin e Institutit te Kerkimeve te Pemeve Frutore dhe Vreshta me Institutin e Ulli Agrumeve berthama e Tiranes mbeti si baze

eksperimentale dhe si e till ju bashkua departamentit te Hortikultures dhe Mbrojtjesse bimeve ne Universitetin Bujqesor Tirane.

Ne vitin 1996 pranoem si pedagog i jashtem ne duke dhene lenden e vreshtarise me studentet e **fakultetit te agronomis**.

Ne 25 qershor te vitit 1999 mbroje doktoraturen me temen e dizertacionit: *“Eksplorimi i resurseve gjenetike autoktone te dardhes ne disa treve te Shqiperise dhe studimi agrobiologjik dhe pomologjik i saj ne treven e Tiranes”* me vleresimin *“Shume mire”* duke mare graden shkencore **“DOKTOR”** ne fushen e shkencave bujqesore.

Gjate viteve 2000 deri ne vitin 2008 vazhdon punen ne eksplorimin e burimeve gjenetike ne kuader te projektit SIDNET, grumbullimi i materialit dhe shumzimi i tyre duke bere te mundur edhe ngritjen e koleksionit te burimeve gjenetike autoktone te specieve molle, dardhe, ftua, kumbull, qersh, vishnje, pjeshke ,zerdeli, bajame ,arra dhe lajthi.

Mbeshtetur ne punen kerkimore te realizuar **ne vitin 2009 mare titullin Profesor i Asociuar**.

Ne vitin 2008 deri me 2011 me nje grup pune u ndermor studimi mbi : *“Studimi mbi gjendjen dhe perspektiven e zhvillimit te drureve arvore (Arra, Geshtenje, Lajthia, Bajamja) dhe Shega ne Shqiperi.”*

Me 2 janar te vitit 2012 mbush moshën dhe dal ne pension. Me gjithë shkeputjen nga universiteti vazhdoj ne evidentimin vleresimin dhe koleksionimin e burimeve gjenetike autokton te mbeshtetur ne kuader te projektit te financuar nga FAO .

Shenim

Puna Kërkimore Shkencore, pjesëmarrja në projekte si dhe botimet janë paraqitur në CV.

Ilir A. ÇIÇI
12.11.2019